



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse



Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____. 2020

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor shpall vend të lirë pune për:

- **1 (një) Specialist Fusha e Mjekësisë në Sektorin e Kujdesit Shëndetësor Parësor dhe Spitalor pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Lezhë.**

Kërkesat e përgjithshme që duhen plotësuar për punësim pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Lezhë janë:

- Të jetë shtetas Shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të përmbush kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
- Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
- Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces në prokurori apo gjykatë;
- Të mos jetë pushuar më parë nga administrata e FSDKSH-së apo shërbimi Civil për thyerje të disiplinës a shkelje të tjera serioze;
- Të ketë mbaruar Fakultetin e Mjekësisë;
- Të jetë i pajisur me Liçensën e ushtrimit të profesionit (për ato që kanë mbaruar fakultetin e Mjekësisë)
- Të ketë njohuri në përdorimin e kompjuterit;
- Zotërimi i gjuhëve të huaja përbën avantazh;
- Të ketë aftësi menaxhuese;
- Të ketë aftësi për të punuar në grup;

Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentat pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Lezhë, **brenda datës 08.07.2020**, këto dokumenta;

- Kërkesë për punësim;
- Përshkrimin e edukimit dhe karrierës profesionale (curriculum vitae).
- Diplomë e noterizuar;
- Diplome Master e noterizuar;
- Listë notash e noterizuar;

- Çertifikat kompjuteri;
- Çertifikatë për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme;
- Referencë pune nga vendi ose vendet e punës ku ka punuar;
- Librezën e punës;
- Fotokopje e kartës së identitetit;
- Dëshmi penaliteti (të datojë brenda 3 muajve të fundit);
- Raport mjekësor për aftësi në punë;
- Liçensën e ushtrimit të profesionit e noterizuar.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara. Dokumentat të dorëzohen në zarf të mbyllur, i cili protokollohet.

Adresa:

**Drejtoria Rajonale e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Lezhë
Rruga: Luigj Gurakuqi, Lagjia “ Besëlidhja”, pranë Maternitetit Lezhë.**